

Bessac-Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBIES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7– 27

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Ortakët e Shoqërisë Bessac Degë e shoqërisë së huaj

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë **Bessac-Degë e shoqërisë së huaj** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Pasiguri Materiale të lidhura me Vijimësinë

Ju tërheqim vëmendjen përse i përket Shënimit 2.3 në pasqyrat financiare ku tregohet se ka pasiguri në lidhje me vazhdimësinë e njësisë ekonomike për të vepruar për shkak të përfundimit të kontratës së ndërtimit. Këto kushte tregojnë për ekzistencën e një pasigurie materiale e cila mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuiojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

12 korrik 2020

Luan Kamberi
Auditues Ligjor



Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë	6		
Totali i aktiveve afatgjatë		-	-
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	7	88,741	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	86,784,136	-
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	9	-	39,356,767
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	50,830,916	291,444
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	11	11,053,977	1,019,075,684
Totali i aktiveve afatshkurtra		148,757,770	1,058,723,895
Totali i aktiveve		148,757,770	1,058,723,895
KAPITALI			
Fitime të mbartura	12	44,402,400	-
Fitimi i ushtrimit		(66,523,117)	908,318,274
Totali i kapitalit		(22,120,717)	908,318,274
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	13	32,696,781	53,489,592
Llogari të pagueshme ndaj palëve e lidhura	14	137,717,824	-
Detyrime tatimore	15	463,882	96,916,029
Totali i detyrimeve afatshkurtra		170,878,487	150,405,621
Totali i detyrimeve		170,878,487	150,405,621
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		148,757,770	1,058,723,895

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	350,281,272	2,605,874,292
Të ardhura të tjera	17	6,510,304	6,624,476
Total të ardhura		356,791,576	2,612,498,768
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	18	(381,768,398)	(1,439,397,309)
Shpenzime personeli	19	(20,936,324)	(30,867,279)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	20	(929,203)	(8,397,873)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(20,039,184)	(23,554,455)
Total shpenzime		(423,673,109)	(1,502,216,916)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	22	836	4,599
Shpenzime të tjera financiare (neto)	23	357,580	(38,095,677)
Fitimi/(humbja) para tatimit		(66,523,117)	1,072,190,774
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	-	(163,872,500)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(163,872,500)
Fitimi/(humbja) e vitit		(66,523,117)	908,318,274
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		(66,523,117)	908,318,274

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019


(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Rezerva rivlerësimi	Rezerva ligjore	Rezerva statutore	Rezerva të tjera	Fitime të mbartura	Fitim / (humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	-	-	-	-	-	19,270,650	19,270,650
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						908,318,274	908,318,274
Transferimi i fitimit te kompania mëmë						(19,270,650)	(19,270,650)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	-	-	-	-	-	908,318,274	908,318,274
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						(66,523,117)	(66,523,117)
Transferimi i fitimit te kompania mëmë					44,402,400	(908,318,274)	(863,915,874)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-	44,402,400	(66,523,117)	(22,120,717)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Bessac Degë e shoqërisë së huaj më 22 maj 2020 dhe janë firmosur si më poshtë.



Z. Dvlan, Administrator Mognol
 Përfaqësues i Bessac Degë e shoqërisë së huaj

Mazars Shpk

Mazars Shpk

Hartues i Pasqyrave Financiare



Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
 No.5, 1000, Tirana, Albania
 phone : +355 42 27 80 15
 www.mazars.al , info@mazars.al

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(66,523,117)	1,072,190,774
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Amortizimi	929,203	8,397,873
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues:		
(Rritje)/rënie në inventar	(88,741)	29,561,306
(Rritje)/rënie në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(97,966,841)	21,817,462
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	130,928,347	(251,702,515)
(Rritje)/rënie në parapagime e shpenzime të shtyra	-	8,645,210
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(32,721,149)	888,910,110
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(110,455,481)	(72,292,054)
Mjetet monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet operative	(143,176,630)	816,618,056
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(14,404,283)	(56,578,282)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	13,475,080	54,908,296
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(929,203)	(1,669,986)
Aktivitetet financuese		
Transferimi i fitimit te kompania mëmë	(863,915,874)	(19,270,650)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(863,915,874)	(19,270,650)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(1,008,021,707)	795,677,420
Mjetet monetare në fillim të periudhës	1,019,075,684	223,398,264
Mjetet monetare në fund të periudhës	11	11,053,977
	11,053,977	1,019,075,684

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Bessac Albania-Degë e shoqërisë së huaj është regjistruar më 17/07/2017 sipas ligjit "Për shoqëritë tregtare". Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj dhe ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare".

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është ndërtimi i tuneleve se linjës furnizuese të gazit pjesë e projektit të gazsjellësit natyror TAP.

Përfaqësues i Shoqërisë është Z. Dylan, Andre, Albert MOGNOL. Adresa e Shoqërisë është Bulevardi 'Dëshmoret e Kombit', Kullat Binjake, Qendra Tregtare, Kati 2, 1019, Tiranë dhe është e regjistruar si dege e shoqërisë së huaj në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L71917008M.

Në 31 dhjetor 2019 shoqëria ka patur 9 punonjës (2018: 2).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në përputhje me dhe ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi. Projekti ndërtimit i tuneleve se linjës furnizuese të gazit pjesë e projektit të gazsjellësit natyror TAP perfundon gjatë 2020. Momentalisht, dega nuk ka kontrata të tjera të lidhura për realizim të punimeve në vend dhe as ndonjë projekt tjetër të pritshëm që do të garantonte vazhdimësinë e aktivitetit në Shqipëri. Aktualisht nuk ka vendim nga kompania mëmë për të mbyllur degën në Shqipëri.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen mbi baza të vazhdueshme dhe bazohen në përvojën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë vlerësimet për ngjarjet e ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme duke marrë parasysh rrethanat e tanishme. Në disa raste menaxhmenti mbështetet në mendimin e ekspertëve të pavarur. Menaxhmenti përdor vlerësime dhe supozime për sa i përket të ardhmes. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet që kanë rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar rregullim material të vlerës mbajtëse të aktiveve dhe detyrimeve, përshkruhen më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"

Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është ose përmban element qiraje, në fillim të kontratës. Shoqëria njih një të drejtë për të përdorur një aktiv dhe një detyrim korrespondues të qirasë në lidhje me të gjitha marrëveshjet e qirasë në të cilat ai aplikon, përveç qirave afatshkurtra (të përcaktuara si qira me një kontratë qiraje prej 12 muaj ose më pak) dhe qira e aseteve me vlerë të ulët (të tilla si tableta dhe kompjutera personalë, sende të vogla mobiljesh, zyra, automjete dhe telefona). Për këto qira, Shoqëria njih pagesat e qirasë si një shpenzim operativ në baza lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë, përveç nëse një bazë tjetër sistematike është më përfaqësuese e modelit të kohës në të cilën konsumohen përfitimet ekonomike nga aktivet e dhëna me qira.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk paguhet në datën fillestare, këto të fundit të skontuara me normën e nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, shoqëria përdor normën e huamarrjes.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë:

Pagesat e qirasë fikse (përfshirë pagesat fikse), minus çdo shumë e arkëtueshme nga qiraja;

Pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, fillimisht e matur duke përdorur indeksin ose kursin në datën fillestare

Shuma që pritet të paguhet nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur;

Çmimi i ushtrimit të opsioneve të blerjes, nëse qiramarrësi është i sigurt për të ushtruar opsionet;

Pagesat e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e një opsioni për të përfunduar qiranë.

Detyrimi i qirasë paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimi i qirasë matet më pas duke rritur vlerën kontabël për të reflektuar interesin mbi detyrimin e qirasë (duke përdorur metodën e interesit efektiv) dhe duke zvogëluar vlerën kontabël për të pasqyruar pagesat e qirasë së bërë.

- Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë:
- Pagesat e qirasë fikse (përfshirë pagesat fikse), minus çdo shumë e arkëtueshme nga qiraja;
- Pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, fillimisht e matur duke përdorur indeksin ose kursin në datën fillestare
- Shuma që pritet të paguhet nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur;
- Çmimi i ushtrimit të opsioneve të blerjes, nëse qiramarrësi është i sigurt për të ushtruar opsionet;
- Pagesat e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e një opsioni për të përfunduar qiranë.

Detyrimi i qirasë paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimi i qirasë matet më pas duke rritur vlerën kontabël për të reflektuar interesin mbi detyrimin e qirasë (duke përdorur metodën e interesit efektiv) dhe duke zvogëluar vlerën kontabël për të pasqyruar pagesat e qirasë së bërë.

Shoqëria ri-mat detyrimin e qirasë (dhe bën një rregullim përkatës ndaj aktivitet të lidhur me të drejtën e përdorimit) sa herë që:

Afati i qirasë ka ndryshuar ose ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethana që rezultojnë në një ndryshim në vlerësimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje. Në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar zbritje.

Pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në një indeks ose normë ose një ndryshim në pagesën e pritshme nën një vlerë të mbetur të garantuar, raste këto në të cilat detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të pandryshuar zbritje (përveç nëse pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të një ndryshimi në një normë interesi variabël, në këtë rast përdoret një normë e rishikuar e skontimit).

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Adoptimi i SNRF 16 "Qirate" (vazhdim)

Nëse një kontratë qiraje modifikohet dhe modifikimi i qirasë nuk llogaritet si një qira e veçantë, në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet bazuar në afatin e qirasë së qirasë së modifikuar, duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë, duke përdorur një normë të rishikuar zbritje në datën efektive të modifikimit. Aktivitet e përdorimit të së drejtës përfshijnë matjen fillestare të detyrimit përkatës së qirasë, pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, minus çfarëdo pagese qiraje dhe çdo kosto fillestare direkte. Ato më pas maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi.

Kurdoherë që Shoqëria të bëjë një detyrim për shpenzimet për çmontimin dhe heqjen e një aktivi të dhënë me qira, dhe riposedon vendin në të cilin është vendosur ose rivendosur aktivi themelor në gjendjen e kërkuar nga termat dhe kushtet e qirasë, një provizion njihet dhe matet sipas SNK 37. Në atë masë që kostot lidhen me një aktiv të përdorimit të së drejtës, kostot përfshihen në aktivin e lidhur me të drejtën e përdorimit, përveç rasteve kur ato shpenzime janë bërë për të prodhuar inventarë.

Aktivitet e përdorimit të së drejtës zhvlerësohen gjatë periudhës më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet themelor. Nëse qiraja transferon pronësinë mbi aktivin themelor ose koston e aktivitet të së drejtës së përdorimit, ky aspekt reflekton faktin që Shoqëria pret të ushtrojë një mundësi blerjeje. Aktivi i lidhur me të drejtën e përdorimit zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktivitet themelor. Zhvlerësimi fillon në datën e fillimit të qirasë. Aktivitet e përdorimit të së drejtës paraqiten si një zë i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Shoqëria aplikon SNK 36 për të përcaktuar nëse një aktiv i përdorimit të së drejtës është zhvlerësuar dhe përbën ndonjë humbje të identifikuar të zhvlerësimit, siç përshkruhet në politikën "Ndërtesa, Makineri dhe pajisje".

Qiratë e ndryshueshme që nuk varen nga një indeks ose normë nuk përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë dhe aktivin e së drejtës së përdorimit. Pagesat e ndërlidhura njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose gjendja që shkakton ato pagesa dhe përfshihen në linjën "Shpenzime të tjera" në fitim ose humbje.

Si një praktikë e përdorshme, SNRF 16 lejon një qiramarrës të mos veçojë përbërësit jo-qira, dhe në vend të kësaj të llogarisë për çdo qira dhe komponentë që nuk lidhen me qira, si një marrëveshje e vetme. Shoqëria nuk e ka përdorur këtë praktikë. Për një kontratë që përmban një përbërës të qirasë dhe një ose më shumë komponentë të qirasë ose jo të qirasë, Shoqëria shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimit relativ të pavarur të komponentit të qirasë dhe çmimit të agergat të pavarur të komponentëve jo-qira.

Shoqëria nuk ka bërë përllogaritje për efekt të IFRS 16, pasi asnjë prej kontratave të qirasë në të cilat ajo është pale, nuk e ka afatin e maturimit më vonë se data 31.12.2019.

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2019, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Përmirësimet vjetore (cikli 2015 -2017) (detyrimisht efektive për periudhën që fillon me 1 janar 2019
- Amendimet në SNRF 9 Karakteristikat e parapagimit me kompensim negative (efektive nga 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 19 "Planet e ndryshimit, mbylljes ose zgjedhjes"(detyrimisht efektiv për periudhat nga ose pas 1 janar 2019)
- Amendimet në SNK 28 "Interesi afatgjatë në partnership dhe joint ventures" (detyrimisht efektiv për periudhat me ose pas 1 janar 2019)
- Interpretimi 23 Pasiguria mbi trajtimin e tatimit të të ardhurave
KIRFN 23 Pasiguria mbi pozicionet e tatimit mbi të ardhurat (efektive nga 1 janar 2019)

3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

3.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve- u lëshua në maj 2017 si zëvendësim për SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve - efektive për periudhat pas 1 Janarit 2021.
- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 - efektive për periudhat pas 1 Janarit 2020
- Ndryshimet në SNRF 3 - efektive për periudhat pas 1 Janarit 2020
- Kuadri Konceptual i Rishikuar për Raportimin Financiar - efektiv për periudhat pas 1 Janarit 2020

4 Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro/ALL	121.77	123.42
USD/ ALL	108.64	107.82

4.2. Instrumentat financiare

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

4. Politikat kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivitet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivitet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivitet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

4. Politikat kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

(Vlerat janë në Lek)

4. Politikat kontabël (vazhdim)

4.4 Aktive afatgjata material (vazhdim)

i. Njohja dhe matja (vazhdim)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë në bazë të vlerës së mbetur:

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa dhe instalime	Vlera e mbetur	5 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje e orendi	Vlera e mbetur	20 %

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

4.7. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

4. Politikat kontabël (vazhdim)

4.7. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimevetë bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.8. Përfitimet e punëmarrësve

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi përfitimi të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

4.9. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë dhe Manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.10. Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.11. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Njohja e të ardhurave

Shoqëria njih të ardhurat duke përdorur metodën kosto plus marzh ku kosto përcaktohet sipas metodës input të njohjes së të ardhurave. Shoqëria përjashton nga metoda input efektet e çdo inputi që nuk paraqet performancën e njësisë ekonomike në transferimin e kontrollit të mallrave apo shërbimeve tek klienti.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, që kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

6. Aktivet afatgjata materiale

Kosto	Instalime teknike, instrumente dhe vegla pune	Pajisje informatike	Të tjera	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,844,120	611,148	4,383,399	6,838,667
Shtesa	34,031,473	326,025	22,220,784	56,578,282
Transferime	(35,875,593)	(937,173)	(26,604,183)	(63,416,949)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-	-
Shtesa	1,859,817	585,417	11,959,049	14,404,283
Pakësime	(1,859,817)	(585,417)	(11,959,049)	(14,404,283)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 31 dhjetor 2017	37,984	26,198	46,598	110,780
Amortizimi i vitit	4,611,722	164,502	3,621,649	8,397,873
Kthim amortizimi	(4,649,706)	(190,700)	(3,668,247)	(8,508,653)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	170,411	61,947	696,845	929,203
Pakësime	(170,411)	(61,947)	(696,845)	(929,203)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,806,136	584,950	4,336,801	6,727,887
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

7. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lëndë ndihmëse dhe të konsumueshme	88,741	-
	<u>88,741</u>	<u>-</u>

8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare ndaj Spiecapag Transadriatica	86,784,136	-
	<u>86,784,136</u>	<u>-</u>

9. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të arkëtueshme ndaj Bessac France	-	39,356,767
	<u>-</u>	<u>39,356,767</u>

10. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogari të arkëtueshme të tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tvsh e kreditueshme	37,155,438	291,444
Tatim fitimi	13,656,038	-
Detyrime doganore	12,134	-
Diamant Shpk, paradhënie për detyrime doganore	7,306	-
	<u>50,830,916</u>	<u>291,444</u>

11. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Vlera monetare në Bankë	10,950,314	1,019,047,766
Vlera monetare në Arkë	103,663	27,918
	<u>11,053,977</u>	<u>1,019,075,684</u>

Bessac Degë e shoqërisë së huaj**Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë në Lek)***12. Kapitali**

Bessac Albania është degë e shoqërisë së huaj Bessac Sas France. Përfaqësues ligjor i shoqërisë së huaj është Z. Dylan, Andre, Albert MOGNOL.

Humbja e vitit ushtimor që u mbyll më 31 dhjetor 2019 është: (66,523,117) lekë. Shoqëria ka fitime të mbartura 44,402,400 lekë.

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Llogari të pagueshme tregtare	32,516,918	53,463,465
Llogari të pagueshme tregtare për fatura të pambërritura	179,863	26,127
	<u>32,696,781</u>	<u>53,489,592</u>

14. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të pagueshme tregtare ndaj Bessac Sas France	137,717,824	-
	<u>137,717,824</u>	<u>-</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për tatim mbi të ardhurat personale	221,105	53,211
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	209,900	44,622
Detyrim tatimi në burim	32,877	-
Detyrim tatim fitimi	-	96,799,443
Detyrime doganore	-	18,753
	<u>463,882</u>	<u>96,916,029</u>

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	350,281,272	2,605,874,292
	<u>350,281,272</u>	<u>2,605,874,292</u>

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

17. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e asetëve	11,833,787	35,685,312
Të ardhura të tjera	7,568,026	7,215,755
Vlera kontabël e aktiveve të shitura	(12,891,509)	(36,276,591)
	<u>6,510,304</u>	<u>6,624,476</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Qarkullimi i tatueshëm	371,513,962
Zbriten të ardhurat e shtyra	-
Kthim i IM 4 me Export	(1,830,877)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	<u>369,683,085</u>
Të ardhura sipas kontabilitetit	<u>369,683,085</u>
Diferenca	<u>-</u>
Të ardhura të tjera	426,303
Të ardhura nga këmbimet valutore	43,661,337
Të ardhura nga interesat	836
Total të ardhura deklaruar në FDP-në e Tatim Fitimit	<u><u>413,771,561</u></u>

18. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Qera pajisjesh	191,845,718	458,883,596
Lëndë ndihmëse dhe e konsumueshme	67,625,043	213,447,033
Nënkontraktorë	44,818,857	181,805,841
Pjesë këmbimi	26,970,691	65,323,353
Shërbime teknike dhe të menaxhimit	18,495,145	375,065,186
Transport	13,663,164	39,569,854
Shërbim ruajtje dhe sigurie	8,485,766	11,507,333
Qera të tjera	2,879,682	6,321,582
Taksa, tarifa doganore dhe shërbime doganore	2,761,035	6,279,878
Shpenzime sigurimi për punonjësit	1,563,790	9,040,638
Lëndë djegëse	886,309	52,942,215
Shpenzime rekrutimi dhe trajnimi për punonjësit	610,510	292,294
Shpenzime nga nxjerrje jashtë përdorimit të asetëve	583,572	22,101,481
Mirëmbajtje / riparime dhe shpenzime kampi	406,980	6,653,137
Shpenzime testimi i cilësisë së ujit	172,136	452,079
(Rimarrje)/Provizione për rreziqe	-	(10,288,191)
	<u>381,768,398</u>	<u>1,439,397,309</u>

19. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	19,467,178	28,891,152
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,469,146	1,976,127
	<u>20,936,324</u>	<u>30,867,279</u>

20. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime amortizimi	929,203	8,397,873
	<u>929,203</u>	<u>8,397,873</u>

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	9,672,393	9,614,083
Shpenzime ligjore e konsulenca	6,069,298	5,599,466
Të tjera shpenzime	1,537,372	936,299
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	867,152	985,480
Shërbime bankare	629,097	1,351,996
Shpenzime telekomunikacioni	346,378	2,292,674
Qera Zyra	329,916	286,256
Shpenzime të ndryshme administrative	275,927	1,383,206
Shpenzime për materiale dhe mirëmbajtje zyrat	200,638	693,982
Gjoha dhe dëmshpërblime	111,013	411,013
	<u>20,039,184</u>	<u>23,554,455</u>

22. Shpenzime/të ardhura interesi dhe të ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit (neto) për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga interesat	836	4,599
	<u>836</u>	<u>4,599</u>

23. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare (neto) paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitime nga këmbimet valutore	43,661,337	43,432,383
Shpenzime te tjera financiare	426,303	(286,048)
Humbje nga këmbimet valutore	(43,730,060)	(81,242,012)
	<u>357,580</u>	<u>(38,095,677)</u>

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	(66,523,117)	1,072,190,774
Total shpenzime të panjohura	10,636,541	20,292,562
Shpenzime për provizione	-	(10,288,191)
Gjoha dhe dëmshpërblime	111,013	411,013
Shpenzime pa dokument të regullt tatimor	1,931,234	2,196,380
Udhëtimi /akomodimi i punonjësve dhe teknikëve nga jashtë	5,358,666	3,278,568
Shpenzime pritje/përcjellje pa dokument të regullt tatimor	646,202	489,074
Shpenzime të pazbritshme nga veprimet me furnitorët	-	286,048
Vlera kontabël e asetëve të nxjerra jashtë përdorimit	583,572	22,101,481
Humbje nga shitja e asetëve	1,773,461	1,737,535
Të tjera shpenzime të pazbritshme	232,393	80,654
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(55,886,576)	1,092,483,336
Humbje fiskale e mbartur	-	-
Tatim fitimi 15%	-	163,872,500
	(66,523,117)	908,318,274

25. Palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Të pagueshme tregtare ndaj Bessac Sas France	-	137,717,824	-	-
Të arkëtueshme tregtare nga Bessac Sas France	-	-	39,356,767	-
	-	137,717,824	39,356,767	-

Transaksionet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Bessac Sas France	17,157,510	204,508,874	39,813,821	731,696,874
	17,157,510	204,508,874	39,813,821	731,696,874

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

26. Manaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- Risku i kreditit
- Risku i likuiditetit
- Risku i monedhës
- Risku i normave të interesit

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe manaximin e riskut dhe manaximin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të manaximit të riskut të shoqërisë. Politikat e manaximit të riskut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monitoruar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaximit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e procedurave të manaximit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesorë financiarë të Shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

(a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit. Shoqëria ndjek të drejtat e paarkëtuara në baza periodike.

	31 dhjetor 2018				
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1 deri ne 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari të arkëtueshme tregtare	-	-	-	-	-
Llogari të arkëtueshme të tjera	39,648,211	-	-	-	39,648,211
Mjete monetare	1,019,075,684	-	-	-	1,019,075,684
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2018	1,058,723,895	-	-	-	1,058,723,895

	31 dhjetor 2019				
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1 deri ne 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari të arkëtueshme tregtare	86,784,140	-	-	-	86,784,140
Llogari të arkëtueshme të tjera	50,830,912	-	-	-	50,830,912
Mjete monetare	11,053,977	-	-	-	11,053,977
Rreziku i kreditit më 31 dhjetor 2019	148,669,029	-	-	-	148,669,029

26. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**(b) Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.

Më poshtë paraqiten aktivet dhe pasivet financiare sipas maturitetit kontraktual të tyre më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2018				
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtushme dhe të tjera	39,648,211	-	-	-	39,648,211
Mjete monetare	1,019,075,684	-	-	-	1,019,075,684
Totali	1,058,723,895	-	-	-	1,058,723,895
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(150,405,621)	-	-	-	(150,405,621)
Totali	(150,405,621)	-	-	-	(150,405,621)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2018	908,318,274	-	-	-	908,318,274
	31 dhjetor 2019				
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari të arkëtueshme	137,615,052	-	-	-	137,615,052
Mjete monetare	11,053,977	-	-	-	11,053,977
Totali	148,669,029	-	-	-	148,669,029
Llogari të pagueshme	(170,878,487)	-	-	-	(170,878,487)
Totali	(170,878,487)	-	-	-	(170,878,487)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	(22,209,458)	-	-	-	(22,209,458)

Bessac Degë e shoqërisë së huaj
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

26. Menaxhimi I riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i valutës

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018			
	EUR	USD	LEK	Total
Llogari të arkëtueshme	39,356,767	-	291,444	39,648,211
Mjete monetare	1,018,196,840	-	878,844	1,019,075,684
Totali	1,057,553,607	-	1,170,288	1,058,723,895
Llogari të pagueshme	-	(53,370,900)	(97,034,721)	(150,405,621)
Totali	-	(53,370,900)	(97,034,721)	(150,405,621)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2018	1,057,553,607	(53,370,900)	(95,864,433)	908,318,274
	31 dhjetor 2019			
	EUR	USD	LEK	Total
Llogari të arkëtueshme	86,784,140	-	50,830,912	137,615,052
Mjete monetare	9,227,865	-	1,826,112	11,053,977
Totali	96,012,005	-	52,657,024	148,669,029
Llogari të pagueshme	(164,673,646)	-	(6,204,841)	(170,878,487)
Totali	(164,673,646)	-	(6,204,841)	(170,878,487)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2019	(68,661,641)	-	46,452,183	(22,209,458)

(d) Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes. Gjatësia e kohës në të cilën norma e interesit është fikse për një instrument financiar përcaktohn se në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivët dhe detyrimet e Shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Nuk ka instrumenta financiarë të cilat mbartin norma interesi.

27. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 5 "Vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare